# Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i shkencave matematike - natyrore |
| **Titulli i lëndës:** | Makroekonomi |
| **Niveli:** | Bsc |
| **Statusi lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | II |
| **Numri i orëve në javë:** | 3 + 2 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 5 |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | |
| **Detajet kontaktuese:** | |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Kjo lëndë ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet kryesore makroekonomike, funksionimin e ekonomisë nacionale dhe ndërkombëtare dhe politikat ekonomike në zbatim. Në pjesën e parë trajtohen çështjet bazike të makroekonomisë duke përfshirë nocionin e makroekonomisë, ekonominë kombëtare, fazën e tranzicionit dhe politikën zhvillimore makroekonomike në Kosovë pas vitit 1999. Në këtë pjesë trajtohen edhe madhësitë globale makroekonomike: Bruto Produkti Vendor (BPV), Bruto Produkti Kombëtar (BPK), tregu, oferta dhe kërkesa agregate, lakorja e ofertës agregate dhe kërkesës agregate, ekuilibri ekonomik.<br>Trajtimi i këtyre temave mundëson që në pjesë tjera të kursit të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me inflacionin dhe deflacionin, llojet dhe shkaqet e inflacionit, lakorja e Filipsit, Kuptimi i papunësisë, llojet e papunësisë, efektet e papunësisë dhe masat për zgjidhjen e papunësisë. Në këtë kurs trajtohet edhe paraja dhe funksionet e parasë, funksionimi i sistemit bankar, politika dhe sistemi fiskal, buxheti i shtetit, marredhëniet ekonomike ndërkombëtare.<br>Konsumi, kursimet dhe investimet, multiplikatori ku përfshihet: multiplikatori i shpenzimeve, multiplikatori i politikës fiskale (multiplikatori i shpenzimeve qeveritare, multiplikatori i taksave dhe multiplikatori i ekonomisë së hapur). |
| | |

| | |
|---|---|
| **Qëllimet e lëndës:** | Përgatitja dhe aftësimi i studenteve për të kuptuar makroekonomine dhe konceptet kryesore makroekonomike, objektivat kryesore makroekonomike, mjetet politike per realizimin e objektivave makroekonomike, te mesoj student se qfare eshte inslacioni, deflacioni, desinsflacioni dhe lakroja e Philipsit. Poashtu, student duhet te mesoj per GDP e GNP si dy koncepte kryesore makroekonomike, Papunesine dhe llojet e papunesise si dhe politikat sociale, te dije se si hartohen politikat monetare dhe ato fiskale, Banka Qndrore dhe roli I saj ne ekonomi, Paraja dhe funksionet e parase, Multiplikatoret ekonomike dhe llojet e tyre, si dhe per marredhenjet ekonomike nderkombetare dhe tendencat e te gjitha ekonomive per te qene pjese integrale e ekonomise globale… |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje të:<br>- Vështrojnë dhe analizojnë politikat zhvillimore dhe ecuritë konkrete ekonomike.<br>- Dijë t'i shqyrtojë dhe analizojë treguesit global makroekonomik si indikatorët më relevant që shprehin nivelin e zhvillimit ekonomik në nivel të ekonomisë kombëtare dhe ndërkombëtare;<br>- Kuptojë postulatet kryesore të ekonomisë së tregut, ofertën dhe kërkesën, si dhe ndikimin e tyre në afarizmin dhe rrjedhat ekonomik në shkallë vendi;<br>- Kuptojnë peshën ekonomike dhe sociale të papunësisë dhe marrjen e masave konkrete për zgjedhjen e saj.<br>- Kuptojnë veprimin e inflacionit në rrjedhat ekonomike dhe në standardin jetësor të popullsisë dhe masat për evitimin apo zbutjen e tij.<br>- Dijë të zbatojë politikën fiskale, politikën Monetare - kreditore dhe politikën e tregtisë së jashtme në funksion të zhvillimit ekonomik te vendit. |
| | |
| | |

| Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|---|---|---|---|
| **Kontributi në ngarkesën e studentit** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 2 | 4 |
| Kolokiume, seminare | 2 | 2 | 4 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | | | 42 |
| Ngarkesa totale orë | | | 125 |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | ▪ Ligjërata,<br>▪ ushtrime,<br>▪ punë individuale,<br>▪ punë eksperimentale,<br>▪ punime seminari,<br>▪ kollokuiume,<br>▪ ese,<br>▪ punë në terren,<br>▪ punë në grupe etj. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | ▪ Provimi mbahet me test<br>▪ Puna praktike dhe seminaret 20 %<br>▪ Testet intermediere (semestrale dhe gjysmësemetrale) (2) 40% |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | 1. Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, "Hyrje në Ekonomi", Shtëpia Botuese<br>"PEGI", Tiranë, 2003. |
| **Literatura shtesë:** | 1. Dornbush & Fischer, Makroekonomia, Tirane, 2010<br>2. |

**Plani i dizejnuar i mësimit:**

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|---|---|

| | |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Njoftimi me planprogramin mësimor të lëndës dhe obligimet e dyanshme profesor – student |
| ***Java e dytë:*** | Hyrje ne makroekonomi,<br>Konceptet kryesore makroekonomike |
| ***Java e tretë*:** | Kerkesa Agregate (AD), Oferta Agregate (AS) dhe Ekuilibri Makroekonomik |
| ***Java e katërt:*** | Treguesit kryesor makroekonomik (GDP e GNP) |
| ***Java e pestë:*** | Papunesia, kuptimi, llojet, efektet dhe masat për zgjidhjen e papunësisë |
| ***Java e gjashtë*:** | Iflacioni, Deflacioni dhe Desinflacioni,<br>Lakorja e Philipsit |
| ***Java e shtatë:*** | Testi I-rë Mes-semestral |
| ***Java e tetë:*** | Paraja dhe funksionet e parasë |
| ***Java e nëntë:*** | Politikat Monetare dhe Kreditore, instrument kryesor per realizimin e objektivave makroekonomike |
| ***Java e dhjetë:*** | Sistemi bankar dhe roli e funksionet e Bankes Qendrore |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | Politikat Fiskale, si instrument kryesor per realizimin e objektivave makroekonomike, Sistemi fiskal dhe nocioni i buxhetit |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Multiplikatori, llojet e tij |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Konsumi dhe Kursimi |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Marredhenjet ekonomike nderkombetare |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Testi II-të Mes-semestral |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet dhe të marrin dhe librat e ushtrimeve.Studentët duhet të vijnë me kohë në mësim, të ruajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog përmes shpjegimit interaktiv gjatë ligjëratave dhe uhtrimeve. Rekomanohet që gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve studentët të q’kyqin telefonat celularë. |